



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:027252

Datë: 30.04.2021

Numri i dokumentit: 01751644

P.nr 148/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Ahmet Rexhaj me sekretaren juridike Lindmire Begolli, në lëndën penale kundër të pandehurit G. H. , sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II nr. 98/21 te dt 13.02.2021 për veprë penale: Heqja apo dëmtim i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 406 te KPRK-se, , pas mbajtjes se seancës publike për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, të mbajtur në prezencën e të pandehurit G. H. , mbrojtësit të tij av. F. A. i autorizuar sipas detyrës zyrtare dhe të prokurori i shtetit Ersan Qavolli , me dt. 29.04.2021 ka marrë dhe publikisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri G. (R.) H. i lindur me ne , ku edhe tani banon ne rr nr 7 , i biri R. dhe nënës M. e vajzërisë Sh. , ka te kryer shkollën e mesme , i martuar baba i 2 fëmijëve, me nr. personale , deri me tani i pa dënuar ,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se

Me dt. 18.10.2020 rreth orës 11:45 min. ne rr hap objektin e sigurisë dhe hyn ne lokalin e tille pa e hequr shenjën zyrtare te vendosur nga inspektori e AUV –it ne atë mënyrë qe i pandehuri G. si menaxher ne lokalin “.....” te cilit me datën 17.10.2020 ne baze te procesverbalit 002704 nga inspektori i AUV-it është mbyllur lokali përkohësisht dhe vendosur shenja zyrtare ne dren e hyrjes por ai edhe përkundër kësaj e hap te njëjtin për tu hetuar me pas hetohet nga inspektoret e lartcekur,

- Me çka ka kryer veprë penale : **Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 te KPRK-së**

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 41,42,43, 46 dhe nenit 406 te KPRK-së , te pandehurin : e gjykon :

DËNIM ME GJOBË

1.Të pandehurit G. H. i cakton dënim me gjobë në shumë prej 400€ (katërqind euro) e të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit .

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, një ditë burgu i llogaritur 20 € të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve shume prej 50 (pesdhjet) euro dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€, si dhe në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit në shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet ne kontest civil.

A R S Y R T N Im

Prokuroria Themelore në Pejë me dt. 18.10.2020 kundër të pandehurit G. H. ka ngritë aktakuzë PP/II nr. 98/21 , për vepre penale: **Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 te KPRK-së** , duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë, ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Bashkë me aktakuzën i ka dërguar gjykatës edhe njoftimin për marrëveshjen e lidhur për pranimin e fajësisë, në ç mënyrë është njoftuar gjykata për detalet dhe është lutur që të mbahet shqyrtimi fillestar sa më shpejtë që është e mundur .

Në seancën për shqyrtimin e marrëveshje mbi pranimin e fajësisë në të cilin kanë mare pjese i pandehuri G. H. , mbrojtësi i tij av. F. A. , dhe prokurori i shtetit Ersan Qavolli është konstatuar –konfirmuar se i pandehuri G. H. , mbrojtësi i tij, dhe prokurori i shtetit me dt.12.02.2021 kanë lidhë marrëveshje për pranimin e fajësisë, dhe të njëjtën marrëveshje përsëri sh e kanë konfirmuar edhe në shqyrtimin gjyqësor, për shqyrtimin marrëveshje mbi pranimin fajësisë , dhe te njëjtën marrëveshje gjyqtari i vetëm gjykues e ka pranuar me aktvendim për pranimin e marrëveshjes – i bindur thellë se marrëveshja e tillë është bërë konform dispozitave te nenit 233 të Kodit të procedurës Penale dhe të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe se marrëveshja i përmban te gjitha kushtet e parapara me dispozitat e lartcekura ,

Pasi që u aprovua përkatësisht u pranua marrëveshja mbi pranimin e fajësisë gjyqtari e konfirmoj edhe vendimin mbi masën ndëshkuese ashtu siç është precizuar edhe në marrëveshjen për pranimin e fajësisë .

Konform nenit 463 par 1 dhe 3 palet e dëmtuara janë udhëzuar në kontest të rregullte civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së.

Konform nenit 39 të Ligjit për kompensimin e viktimave i pandehuri është i obliguar në pagesën e taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit ,

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 148/21 të dt 29.04.2021

Sekretarja juridike

Gjyqtari

Lindmire Begolli

Ahmet Rexhaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
dita e marrjes, Gjykatës të Apelit në Prishtinë
e përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2021:027252
Datë: 30.04.2021
Numri i dokumentit: 01751644